



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV:

Barasvlera dhe njohja e dokumenteve të arsimit parauniversitar të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës

NUMËR: 03/2012

Datë: 02.05.2012

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet; 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës dhe nenit 14 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr UA:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi është të rregullojë procedurën e kryerjes së barasvlerës dhe të njohjes së dokumenteve shkollore të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës, si dhe punën e komisionit për barasvlerë.

Neni 2 Njohja

1. Barasvlera dhe njohja e dëftesave, diplomave dhe e dokumenteve të tjera që janë marrë në vendet e huaja, bëhet në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë (më tutje, MASHT) sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

2. Njohja e dëftesës së arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë nga MASHT, është e vlefshme vetëm në Republikën e Kosovës .
3. MASHT-i, e bën barasvlerën dhe njohjen e dëftesave dhe të diplomave të arsimit dhe të aftësisimit profesional (AAP) për punët ose për profesionet e caktuara në botën e jashtme.
4. Barasvlera e dëftesave dhe e diplomave bëhet nga komisioni, ndërsa njohja nga zyra për barasvlerë dhe njohje.

Neni 3 Kërkesa

1. Për barasvlerën dhe njohjen e dokumenteve, kandidati duhet të dorëzoj këto dokumente:
 - 1.1. Kërkesën;
 - 1.2. Originalin e diplomës ose dëftesës në shikim për nivelin e shkollimit;
 - 1.3. Fotokopjen e diplomës ose dëftesës për nivelin e shkollimit.
2. Dokumentet e shkollimit të nivelit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë duhet të jenë të përkthyer nga përkthyesi i autorizuar në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
3. Në rast se nevojiten dokumente shtesë, parashtruesi i kërkesës është i obliguar t'i sigurojë.

Neni 4 Kriteret

1. Me rastin e barasvlerës dhe të njohjes së dëftesës apo të diplomës së marrë jashtë Kosovës, merret në konsiderim sistemi i shkollimit nga ai vend, plani dhe programi mësimor i shkollës ku është marrë dëftesa, kushtet e pranimit në shkollë, zgjatja e shkollimit si dhe rrethanat e tjera që kanë rëndësi për barasvlerë dhe njohje.
2. Në qoftë se, gjatë procedurës së barasvlerës dhe të njohjes konstatohet se planet, programet dhe kriteret tjera nga paragrafi 1 i këtij neni janë nën 70% të planprogrameve dhe kriterëve të tjera për nxënësit që shkollohen në Kosovë, barasvlera dhe njohja e dëftesës duhet të kushtëzohen me dhënien e provimeve plotësuese.
3. Nëse Republika e Kosovës lidh marrëveshje me shtetet tjera për njohjen reciproke të dëftesave ose të diplomave, barasvlerësimi do t'i njihet në pajtim me këtë marrëveshje.

Neni 5 Provimi

1. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara me nenin 4 paragrafi 2 të këtij udhëzimi administrativ, duhet t'u nënshtrohet provimeve plotësuese në shkollën përkatëse.
2. Provimet duhet të jepen më së voni deri në përfundimin e notave nga klasa në të cilën është regjistruar nxënësi me kusht.
3. Nxënësit të cilët kanë mbaruar shkollën e mesme të lartë, por nuk e kanë diplomën, u bëhet barasvlera e dëftesave dhe pastaj ata duhet t'i nënshtrohen provimit të maturës për ta marrë diplomën.

Neni 6

Komisioni për barasvlerë dhe njohje

1. Barasvlerën dhe njohjen e dokumentit për klasat e kryera në arsimin fillor, në arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë, e bën komisioni i zgjedhur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë.
2. Komisioni përbëhet prej tre anëtarëve.
3. Komisioni thirret sipas nevojës nga kryetari i tij.
4. Anëtarët e komisionit duhet të jenë nga profilet arsimore.

Neni 7

Detyrat e Komisionit

1. Komisioni shqyrton dhe analizon dokumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesave për barasvlerën e tyre.
2. Pas shqyrtimit të dokumenteve komisioni merr vendim për shkallën e shkollimit të arritur jashtë Republikës së Kosovës.
3. Gjatë punës së komisionit mbahet procesverbali të cilin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e komisionit.
4. Pas përfundimit të procedurave për barasvlerë dhe njohje lëshohet vendimi.
5. Vendimin e nënshkruan zyrtari për barasvlerë dhe njohje të dokumenteve të AP.
6. Vendimi përcakton shkallën e shkollimit të mbaruar.
7. Afati për dhënien e vendimit është 15 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës.

Neni 8

Regjistrimi

1. Kandidati i cili ka paraqitur kërkesë për barasvlerë dhe njohje për arsimin e detyrueshëm, mund të regjistrohet me kusht me afat prej 15 ditësh derisa të kryhet procedura e njohjes.
2. Regjistrimi i personave nga paragrafi 1 i këtij neni, bëhet në bazë të vërtetimit të lëshuar nga zyrtari për barasvlerë dhe nostrifikim .

Neni 9

Sistemimi

1. Nxënësit të cilët kthehen në Republikën e Kosovës sistemohen në këtë mënyrë:
2. Nëse nxënësi kthehet nga vendet jashtë Kosovës në fund të dymujorit të parë të gjysmëvjetorit të parë, regjistrohet në shkollë i përcjellë mësimet dhe vlerësohet si nxënësit e tjerë .
3. Nëse nxënësi kthehet në fund të gjysmëvjetorit të parë i ndjek mësimet në gjysmëvjetorin e dytë, vlerësohet si nxënësit tjerë dhe këto nota janë nota të vitit.
4. Nëse nxënësi kthehet në fund të dymujorit të parë të gjysmëvjetorit të dytë, nxënësi shkon në shkollë si dëgjues, nuk regjistrohet në ditar dhe nuk notohet .
5. Këtyre nxënësve u bëhet njohja e dëftesës dhe konsiderohen se kanë mbaruar vitin në vendet prej nga vijnë.

Neni 10 Avancimi

Nxënësit të cilët për shkak të mos përvetësimit të gjuhës në shtetet ku shkojnë ua humbin ndonjë vit shkollor dhe kanë kaluar moshën për shkallën e shkollimit përkatës, mund të avancohen me vendim të komisionit për avancim.

Neni 11 Përmbajtja e vendimit

1. Vendimi përmban:
 - 1.1. Emrin e institucionit që e bën njohjen e dokumenteve;
 - 1.2. Numrin dhe datën e vendimit;
 - 1.3. Emrin dhe mbiemrin e kandidatit;
 - 1.4. Datën dhe vendin e lindjes së kandidatit;
 - 1.5. Nivelin e shkollimit;
 - 1.6. Suksesin e përgjithshëm në dëftesën e marrë jashtë (suksesi përshkruhet pa nota numerike);
 - 1.7. Shtetin i cili ka lëshuar dokumentin;
 - 1.8. Të drejtën e mëtejme të kandidatit për vazhdimin e shkollimit.

Neni 12 Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit

1. Për dokumentacionin e njohur në arkiv duhet ruajtur:
 - 1.1. Kërkesa;
 - 1.2. Fotokopja e dokumentit të njohur;
 - 1.3. Vendimi i lëshuar;
 - 1.4. Fletëpagesa.

Neni 13 Pagesa e taksës

1. Kandidati paguan një taksë të caktuar për administrimin dhe procedurën e komisionit si:
 - 1.1. Për dëftesa kandidati paguan 5 €;
 - 1.2. Për diplomë 10 €.

Neni 14 Ankesa


Pala e pakënaqur mund të ankohet në afat prej 15 ditëve pranë Komisionit për ankesa dhe parashtrës në MASHT.

Neni 15
Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, shfuqizohen UA nr. 1/2004 datë 20.01.2004 dhe UA nr. 7/2004 datë 02.03.2004 të cilat e kanë rregulluar më parë këtë fushë.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Udhëzimi administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.


Prof. dr. Ramë Buja, ministër

